



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2025



Komuna e Kaçanikut

PROCESVERBAL

Takimi i VI-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025

Data: 16.12.2025

Vendi: Komuna e Kaçanikut

Të pranishëm:

- Sabedin Vishi – Kryetar i Komunës
- Emrush Lalinovci – Stacioni i Policisë, Kaçanik
- Fatmir Qaka – EVSB
- Shemsedin Abazi – KLSP
- Elmihane Malsiu – HANDIKOS
- Fidaim Fazliu – Bashkësia Islame
- Zahir Doda – Drejtori i DAK
- Naim Hysa – Kryqi i Kuq Komunal
- Ylber Tusha – Përfaqësues i bizneseve
- Jashar Selimi – Këshilli i Prindërve
- Vedat Dema – Zyra për Barazi Gjinore

Mbledhjen e kryesoi **Kryetari i Komunës**, z. Sabedin Vishi, me këtë rend dite:

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
 2. Gjendja e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve
 3. Përmbyllja e vitit dhe rekomandimet për vitin 2026
 4. Të ndryshme
-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht nga të pranishmit.

2. Gjendja e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve

Kryetari i Komunës i dha fjalën Komandantit të Stacionit Policor në Kaçanik, z. Emrush Lalinovci.

Emrush Lalinovci theksoi se gjendja e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve ka qenë e **qetë dhe stabile**. Ai njoftoi se për këtë periudhë është përgatitur një raport i detajuar, i cili është shpërndarë në formë fizike tek anëtarët e pranishëm. Ai shtoi se është i gatshëm të japë sqarime shtesë për çdo çështje që mund të jetë me interes për anëtarët.

Vedat Dema përgëzoi Policinë për raportin e përgatitur dhe kërkoi informacione shtesë lidhur me dy raste të dhunës në familje të përfshira në raport, konkretisht për fazën e trajtimit të tyre.

Emrush Lalinovci u përgjigj se për këto dhe për çdo rast tjetër, anëtarët mund të kontaktojnë drejtpërdrejt Stacionin Policor për të marrë informacione më të detajuara nga zyrtarët përgjegjës.

Fidaïm Fazliu theksoi se nga raporti vërehet një rënie e disa rasteve të veprave të caktuara, gjë që përbën një lajm pozitiv. Ai ngriti gjithashtu një shqetësim lidhur me aksidentet e shpeshta në rrugën **Bajnicë – Duraj – Rakaj**, duke theksuar se megjithëse ka shenja komunikacioni, shikueshmëria për vozitësit është e pamjaftueshme. Sipas tij, ndërtimi i një rrethrotullimi në atë pjesë do të ishte një zgjidhje e mirë.

Kryetari i Komunës theksoi se ka pasur kërkesa nga komuniteti për ndërtimin e një rrethrotullimi në atë pjesë, por realizimi ka qenë i pamundur për shkak se toka figuron pronë private. Ai shtoi se do të shqyrtohet mundësia e shpronësimit të pronës përkatëse dhe më pas mundësia e realizimit të projektit.

Shemsedin Abazi ngriti shqetësimin për parkimin e veturave përgjatë trotuareve në rrugën **“Idriz Seferi”**, duke theksuar se kjo po vështirëson lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe hyrjen në objektet e banimit.

Emrush Lalinovci u zotua se ky shqetësim do të merret në konsideratë dhe do të ndërmerren masa sipas kompetencave ligjore. Ai shtoi se mungesa e hapësirave për parking është një problem i përgjithshëm në qytet, por ligji duhet të zbatohet pavarësisht ankesave të qytetarëve.

Zahir Doda ngriti shqetësimin për përdorimin e substancave narkotike, fenomen i cili sipas tij po prek sidomos rininë shkollore. Ai kërkoi të dijë nëse shpërndarësit e këtyre substancave janë kryesisht vendas apo vijnë nga komunat tjera.

Emrush Lalinovci theksoi se në shumicën e rasteve shpërndarësit janë **persona vendas**.

Fidaim Fazliu kërkoi sqarime lidhur me procedurat që ndërmerren kur kapet një person si shpërndarës i substancave narkotike.

Emrush Lalinovci sqaroi se personat e dyshuar fillimisht i nënshtrohen procedurave policore, ku mbledhen të gjitha dëshmitë e nevojshme dhe më pas rastet përcillen në organet e drejtësisë. Ai shtoi se në disa raste, personat lirohen në procedurë të rregullt nga gjykata.

Kryetari i Komunës ngriti çështjen e mungesës së zyrtarëve policorë, e cila më herët ishte përmendur si vështirësi për trajtimin e rasteve.

Emrush Lalinovci theksoi se megjithëse numri i zyrtarëve policorë nuk është i mjaftueshëm, Policia nuk jep arsye time për këtë dhe në rast nevojë kërkon mbështetje nga niveli rajonal.

Fatmir Qaka pyeti për masat që janë ndërmarrë në parandalimin e dukurisë së lypësarëve.

Emrush Lalinovci theksoi se kjo dukuri është shqetësuese dhe trajtohet sipas procedurave ligjore, duke u përcjellë në organet e drejtësisë. Ai shtoi se në nivel nacional është duke u përgatitur një plan për trajtimin e kësaj dukurie.

3. Përmbyllja e vitit dhe rekomandimet për vitin 2026

Kryetari i Komunës njoftoi se para anëtarëve janë shpërndarë rekomandimet e nxjerra nga takimet e KKSBB-së gjatë vitit paraprak. Ai ftoi të pranishmit që të japin propozime shtesë për rekomandime për vitin 2026.

Ai theksoi se institucionet komunale do të angazhohen për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me mundësitë dhe kompetencat e tyre, duke kërkuar gjithashtu bashkëpunim më të madh nga institucionet lokale, qendrore dhe komuniteti.

Zahir Doda, në cilësinë e koordinatorit të KKSBB-së gjatë këtij mandati, falënderoi të gjithë anëtarët për bashkëpunimin e mirë gjatë këtij mandati. Ai veçoi kontributin e **Fatmir Qakës** për angazhimin në organizimin e takimeve, përgatitjen e raporteve dhe procesverbaleve. Ai shtoi se sipas përfaqësuesve të nivelit qendror, Komuna e Kaçanikut është vlerësuar si një nga komunat shembull për funksionimin e KKSBB-së në Kosovë.

4. Të ndryshme

Shemsedin Abazi ngriti çështjen e një aksidenti me zjarr që kishte ndodhur disa ditë më parë në një banesë në rrugën “**Idriz Seferi**”, ku për fat të mirë nuk kishte të lënduar, por dëmet materiale ishin të konsiderueshme. Ai pyeti nëse është ndërmarrë ndonjë veprim për të ndihmuar familjen e prekur.

Kryetari i Komunës njoftoi se është takuar me familjarët dhe është formuar një komision për vlerësimin e dëmit. Gjithashtu, familjes i është mundësuar strehim i përkohshëm në banimin social në **Kaçanikun e Vjetër**, ndërsa do të shqyrtohen edhe mundësitë për ndihmë financiare.

Meqenëse nuk pati diskutime të tjera, Kryetari e shpalli të përfunduar takimin, duke uruar të pranishmit për festat dhe duke shprehur shpresën që viti i ardhshëm të jetë një vit i suksesshëm me projekte dhe bashkëpunim të mirë në funksion të rritjes së sigurisë për qytetarët.

Rekomandime

1. **Drejtoria për Shërbime Publike**, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të shqyrtojë mundësinë e **ndërtimit të një rrethrrrotullimi në segmentin rrugor Bajnicë – Duraj – Rakaj**, me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion.
2. **Policia e Kosovës**, në bashkëpunim me organet komunale, të intensifikojë **kontrollat dhe masat ndaj parkimeve të parregullta në rrugën “Idriz Seferi”**, me qëllim të lehtësimit të lëvizjes së qytetarëve.
3. **Institucionet komunale dhe ato arsimore**, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të ndërmarrin **aktivitete vetëdijesuese për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike**, veçanërisht tek rinia shkollore.
4. **Institucionet përgjegjëse të vazhdojnë trajtimin e dukurisë së lypësarëve**, në bashkëpunim me institucionet e drejtësisë dhe shërbimet sociale.
5. **Komuna e Kaçanikut të shqyrtojë mundësitë për krijimin e hapësirave shtesë për parking publik**, në mënyrë që të zvogëlohen parkimet e parregullta në zonat urbane.
6. **KKSB të vazhdojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe raportimin e rregullt për gjendjen e sigurisë**, me qëllim të rritjes së sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve.

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z.Sabedin Vishi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

